



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Study program Politeknikë (2023/2024)

Fakulteti	Shkencat dhe Teknologjitë Bashkëkohore
Cikli i studimeve	Cikli i parë (Deridiplomike)
SETK	180
Titulli	I Diplomuar në Politeknikë
Numri në arkiv i akreditimit [180]	03-1854/1
Vendimi për fillim me punë	
Data akreditimit	22.06.2023

Përshkrimi i programit

Fakulteti i Shkencave dhe Teknologjive bashkëkohore në SEEU - Tetovë është institucion i arsimit të lartë, detyra kryesore e të cilit është kryerja e arsimit të lartë, aktiviteteve kërkimore në fushën e shkencave kompjuterike, inxhinierisë kompjuterike, informatikës së biznesit, shkencave të të dhënave, inxhinierisë softuerike, shkencave arkitektonike dhe shkencat politike. Arsyetimi për prezantimin e programit të ri studimor lind nga ndjekja e rekomandimeve të Deklaratës së Bolonjës dhe proceset e zbatimit të programeve të akredituara më parë. Duke patur nevojën për të mundësuar përzgjedhje sa më të gjerë të programeve studimore kompatible, në të njëjtën kohë justifikon konceptin e mobilitetit të drejtimeve dhe studentëve ju mundëson zgjedhjen e drejtimit sipas afiniteteve dhe aftësive të tyre.

Drejtimi ka për qëllim t'ju përgjigjet kërkesave për përshtatshmëri më të madhe me qendrat dhe universitetet tjera europiane dhe botërore të studimit të këtij drejtim dhe në të njëjtën kohë e përshtat atë me kushtet konkurente të tregut. Në veçanti, që struktura e programit të propozuar të studimit shpjen nga lëndë të përgjithshme drejt atyre të specializuara të përqendruara në përcaktimin e drejtimit në bazë të praktikave dhe njohurive të mësuara dhe jo në bazë të zgjedhjes arbitrare. Përvetësimi gradual i materies në vazhdimësi ndan vëmendjen nga inxhinieria arkitektonike në fushën e artit figurativ-vizual dhe në atë historiko-filozofik të arsimit, si faktor i dytë opcional.

Karriera

Studentët që përfundojnë me sukses programin do të jenë në gjendje të ofrojnë shërbime me përvojë për trajnimin e teknikëve, profesionistëve dhe studiuesve përmes programeve përkatëse në fusha të ndryshme të dijes, mundet të kryejnë kërkime shkencore dhe teknologjike, promovime të inovacioneve dhe nxitjen e lidhjeve dhe kontaktet me sektorët prodhues dhe social për të kontribuar në zhvillimin e vendit, zhvillimin teknologjik, ekonomik, politik, social dhe kulturor.

Rezultatet e të mësuarit

Njohuritë dhe të kuptuarit

- Përvetësimi i njohurive dhe të kuptuarit në aspektin teorik dhe praktik në fushën e shkencave politike.
- Njohuritë përfshijnë fusha kryesore si matematika inxhinierike, statika, forca e materialeve, inxhinieria elektrike.
- Njohuri dhe të kuptuarit e metodologjive të ndryshme të programimit në skenarët praktik të zgjidhjes së problemeve

(dizajn, perspektivë, etj.)

- Njohuri dhe të kuptuarit në kryerjen e hulumtimeve në shkallë të vogël dhe aplikimin e projekteve të projektimit me ndihmën e kompjuterit.

Aplikimi i njohurive dhe të kuptuarit

- Aftësi për të aplikuar/përdorur sisteme kompjuterike dhe sisteme të informacionit në detyrat e zakonshme të punës gjatë projektimit të zgjidhjeve arkitekturore.
- Aftësi për të menaxhuar dhe mirëmbajtur projekte, duke përdorur metodologji, mjedise dhe praktika të ndryshme të zhvilluara.
- Aftësia për të hartuar dhe zbatuar projekte arkitekturore duke filluar nga përmasat e vogla dhe të mesme.
- Aftësi për t'u organizuar në një mënyrë për të zgjidhur detyra të ndryshme sociale, ekonomike, inxhinierike dhe/ose teknologjike.
- Të propozojë zgjidhje për sistemet inxhinierike në nivel fillestar dhe të mesëm, duke përfshirë analizën, zhvillimin e projektimit dhe raportimin.

Aftësitë për të vlerësuar

- Aftësi për të mbledhur dhe analizuar materiale për të propozuar zgjidhje.
- Aftësi për të vlerësuar dizajne të ndryshme dhe mjedise të zhvilluara.
- Aftësi për të vlerësuar zgjidhje të ndryshme arkitekturore.

Aftësitë e komunikimit

- Aftësi për të ndjekur përparimet në fushën e inxhinierisë politeknike, aftësi për të mësuar shpejt teknologjitë, mjetet dhe kornizat e reja.
- Aftësia për të aplikuar shkathtësitë e të mësuarit në mësimdhënie dhe trajnim në sistemet politeknike në shkolla ose organizata.
- Aftësia për të aplikuar shkathtësitë e të mësuarit në krijimin dhe menaxhimin e projekteve.

Aftësitë e të mësuarit

- Aftësi për të ndjekur zhvillimet në fushën e inxhinierisë politeknike, aftësi për të mësuar shpejt teknologjitë, mjetet dhe kornizat e reja.
- Aftësia për të aplikuar shkathtësitë e të mësuarit në mësimdhënien dhe trajnimin e sistemeve të informacionit në shkolla ose organizata.
- Aftësia për të aplikuar shkathtësitë e të mësuarit në krijimin dhe menaxhimin e projekteve.

Lista e lëndëve

Semestri 1

- [C2023] [6.0 SETK] **Bazat e projektimit**
- [C2024] [6.0 SETK] **Gjeometri Deskriptive**
- [C2361] [6.0 SETK] **Matematika për Inxhinierë 1**
- [3.0 SETK] **Gjuhë shqipe/maqedonase**
- [3.0 SETK] **Gjuhë angleze**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore nga kompetencat digjitale**

Semestri 2

- [C2028] [6.0 SETK] **Principet e projektimit**
- [C2029] [6.0 SETK] **Perspektiva**
- [C2368] [6.0 SETK] **Matematika për inxhinierë 2**
- [3.0 SETK] **Gjuhë shqipe/maqedonase**
- [3.0 SETK] **Англиски јазик**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore nga kompetencat digjitale**

Semestri 3

- [C2362] [6.0 SETK] **Hyrje në statikë**
- [C2037] [6.0 SETK] **Projektimi përmes kompjuterit**
- [EBE-408] [6.0 SETK] **Menaxhimi i Projekteve**
- [C2363] [6.0 SETK] **Fizika 1**
- [C2069] [3.0 SETK] **Komunikim verbal**
- [3.0 SETK] **Gjuhë angleze**

Semestri 4

- [CCE-101] [6.0 SETK] **Bazat e elektroteknikës**
- [C2364] [6.0 SETK] **Menaxhimi Strategjik**
- [C2042] [6.0 SETK] **3D modelimi kompjuterik dhe realiteti virtual**
- [C2365] [6.0 SETK] **Fizika 2**
- [C2070] [3.0 SETK] **Komunikim me shkrim**
- [3.0 SETK] **Gjuhë angleze**

Semestri 5

- [C2366] [6.0 SETK] **Rezistenca e materialeve**
- [C2033] [6.0 SETK] **Dizajn studio I**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore nga njësi tjera**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore e përgjithshme**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore e përgjithshme**

Semestri 6

- [C2367] [6.0 SETK] **Punim diplome**
- [C2038] [6.0 SETK] **Dizajn studio II**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore nga njësi tjera**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore e përgjithshme**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore e përgjithshme**

Description of courses

Lëndë obligative

- **Bazat e projektimit**
Qëllimi i lëndës është që t'i njoftojë studentët me procesin e projektimit dhe analizës arkitekturore. Studenti të njoftohet me konceptet themelore të formës dhe hapësirës arkitekturore, mënyrën e paraqitjes grafike dhe normativat e dimensionimit të elementeve bazike të projektimit.
- **Gjeometri Deskriptive**
Qëllimi i lëndës: Përdorimi i metodave moderne grafike, të cilat përdoren në zgjidhjen e problemeve inxhinierike, teknike dhe të projektimit. Zhvillimi i perceptimit hapësinor të formave tredimensionale të objekteve dhe aftësia për të treguar marrëdhënie të ndryshme të ndërsjella të karakteristikave të tyre gjeometrike në një plan dydimensional.
- **Matematika për Inxhinierë 1**
Qëllimi i lëndës: Të përvetësohen kuptimet themelore nga vargjet dhe limiti i vargut real, funksionet me nje ndryshore reale, limiti i funksionit, si dhe njehsimi diferencial i funksioneve me ndryshore reale, të cilat janë të nevojshme për studimin e shkencave teknike.
- **Principet e projektimit**
Qëllimi i lëndës është që studenti të njoftohet me metodologjinë bazike të projektimit dhe analizës arkitekturore përmes studimit të sistemeve të objektit/ hapësirës arkitekturore: sistemi hapësinor-funksional, konstruktiv, i qarkullimit dhe i mbështjelljes. Studenti, do të njoftohet me principet elementare të kompozicionit të hapësirës arkitekturore si: aksi, simetria, hierarkia, datum, ritmi, transformimi.
- **Perspektiva**

Qëllimi i kësaj lënde është që studenti të aftësohet për paraqitjen e përjetimit estetik vizual në vizatim teknik hapësinor. Parimet e perspektivës dhe paraqitjes tredimensionale, do të studiohen me qëllim që studenti të aftësohet që projektet grafike arkitekturore t'i paraqesë në mënyrë tredimensionale, të qartë dhe të lexueshme për publikun e thjeshtë joarkitekturor.

- **Matematika për inxhinierë 2**

Qëllimi i lëndës: Të njihen dhe të aftësohen studentët me njehsimin integral dhe zbatimin, ekuacionet diferenciale të zakonshme, zgjidhjen dhe aplikimin e tyre, funksionet me shume ndryshore, si dhe me njehsimin e integraleve të dyfishta dhe trefishta dhe zbatimin e tyre në zgjidhjen e problemeve nga fusha e shkencave teknike.

- **Hyrje në statikë**

Qëllimi i lëndës: Njohja me konceptet themelore të statikës si një mjet për të kuptuar sistemet më elementare konstruktive. Paraqitje themelore analitike dhe praktike në parimet dhe konceptet fizike të statikës.

- **Projektimi përmes kompjuterit**

Objekti kryesor i kësaj lënde është që t'i njoftojë studentët me bazat e dizajnit me ndihmën e kompjuterit (CAD). Duke përdorur paketat programuese CAD, studenti do të përgatitë arkitekturë të plotë tredimensionale. Sistemet e dizajnit me ndihmën e kompjuterit (CAD) mundësojnë zgjidhje të shumta, duke i vlerësuar ato dhe nëse është e nevojshme bën korrigjim e dizajnit. Elemente të grafikës 2D dhe 3D, elemente tredimensionale të shtresave të imazheve kompjuterike, projeksionet e elementeve bazë grafike, pamjet, seksionet, transformimet, rrotullime dhe perspektiva do të jenë pjesë e kësaj lënde si dhe përdorimi i mjeteve të vizatimit të elementeve strukturorë.

- **Menaxhimi i Projekteve**

Qëllimi i lëndës është që të inkuadrohen studentët në botën e projekteve moderne dhe t'i ballafaqojë ata me mundësitë dhe me sfidat e jetës reale ekonomike në krijimin e projekteve të përshtatshme për nevojat reale. Qëllimet specifike të lëndës janë: si të përcaktohet një projekt i caktuar (duke përdorur disa faza) dhe të theksohet roli i rëndësishëm i menaxherit të projektit (të kuptohen nevoja, fusha e veprimit, aktivitetet për implementim, kompleksiteti i dizajnit modern, etj.). Studentët duhet të trajnohen se si të aplikojnë mjete dhe teknika moderne të menaxhimit modern të projektimit me rastin e transformimit të nevojës, ose të ideojnë krijuese në një projekt real e të dokumentuar, i cili do të bëjë të jenë më inventivë për vete dhe më kompetitivë në tregun më konkurrues të punës.

- **Fizika 1**

Qëllimi i lëndës: Njohja e studentëve të drejtimit Politeknikë me konceptet bazë të fizikës që do tu ndihmonte në zhvillimin profesional në pajtim me kompetencat e programit studimor të politeknikës.

- **Komunikim verbal**

Objektivat e programit të lëndës: - Të zhvillojnë aftësitë e komunikimit verbal. - Të jenë në gjendje të përfshihen aktivisht në një diskutim mbi një temë të veçantë. - Të zotërojnë teknikat për komunikim të suksesshëm. - Të shprehin mendimin e tyre kritik për tema të caktuara. - Të zbatojnë teknikat e adaptuara në karrierën e tyre profesionale.

- **Bazat e elektroteknikës**

Lënda paraqet hyrje në konceptet bazë të elektroteknikës. Studentëve iu mundëson të kuptuarit e ligjeve, parimeve dhe dukurive themelore në lëmin e elektroteknikës. Përmes qasjes teorike dhe praktike iu mundëson aplikimin e njohurive dhe shkathtësive të fituara në lëndët vijuese profesionale dhe të specializuara në kuadër të programit studimor. Paralelisht trajtohen bazat e elektricitetit dhe magnetizimit dhe në këtë kontekst edhe rrymat elektrike, qarqet elektrike të rrymës njëkatore, rrymat sinusoidale, qarqet RLC, qarqet elektrike bazike dhe komplekse, si dhe metodat për zgjidhjen e rrjeteve elektrike dhe instalimeve elektrike.

- **Menaxhimi Strategjik**

Lënda e Menaxhimit Strategjik është hartuar në mënyrë të tillë që t'u mundësojë studentëve të vlerësojnë dhe zbatojnë elementët kryesorë të analizës strategjike, të zgjedhin strategjinë e duhur brenda një plani fleksibël, si dhe të inkurajojnë reflektimin mbi problemet që lidhen me zbatimin e strategjisë së formuluar. Qëllimi i mësimi të lëndës është që nxënësit të mësojnë të mendojnë në mënyrë kritike për çështjet dhe problemet që lidhen me zgjedhjen e strategjisë në një mjedis të turbullt dhe dinamik dhe të kuptojnë se nuk ka asnjë mënyrë të vetme të drejtë për të zhvilluar një strategji. Pas përfundimit të ligjëratave, studentët duhet të jenë në gjendje: - të kuptojë teoritë dhe konceptet e menaxhimit strategjik; - të zotërojnë fjalorin lidhur me menaxhimin strategjik; - të integrojnë njohuritë e marra nga menaxhimet e veçanta funksionale; - të zhvillojnë aftësi analitike dhe komunikuese, si dhe aftësi të punës

në grup.

- **3D modelimi kompjuterik dhe realiteti virtual**

Qëllimi i kësaj lënde është t'i njoftojë studentët me një bazë të plotë aplikative në praktikën e modelimit 3D, dhe përdorimin e tij në realitetin virtual. Studentët, do të mësojnë se si të dizajnojnë dhe gjenerojnë përmbajtje 3D për VR, duke përdorur mjete dhe teknika më të fundit. Studentët, do të mësojnë të zbatojnë proceset e punës në modelimin 3D dhe të menaxhojnë procesin e renderimit. Teknika të ndryshme modelimi do të studiohen nga renderimi manual, skulpturimi 3D deri tek interpretimi automatik i objekteve në shkallë të vogël dhe të madh. Studentët, do të mësojnë se si të zhvillohen për mjediset VR, të gjenerojnë skena të avancuara dhe të vendosin këto mjedise VR.

- **Fizika 2**

Qëllimi i lëndës: Njohja e studentëve të drejtimit politeknikë me konceptet bazë të fizikës që do tu ndihmojë në zhvillimin profesional në pajtim me kompetencat e programit studimor të politeknikës, në vazhdim të njohurive të fituara në Fizika 1.

- **Komunikim me shkrim**

Objektivat e programit të lëndës: Për të fituar njohuri në lidhje me procesin e të shkruarit (fazat në krijimin e një teksti). - Të miratojë normat standarde të gjuhës. - Të arrihet një nivel akademik për shprehje me shkrim në shqip, maqedonisht ose anglisht, i cili do të zbatojë njohuritë e marra më parë të gjuhës standarde. - Të inkurajojë motivimin e studentëve për shprehje me shkrim pavarësisht nga llojet dhe format e tekstit. - Të miratojë kriteret e tekstualitetit, të cilat janë thelbësore për një tekst. - Përvetësimi i aftësive për kërkimin e materialeve (biblioteka dhe burimet online).

- **Rezistenca e materialeve**

Qëllimi i lëndës: Përvetësimi i aftësive për të analizuar gjendjen e sforcimeve dhe deformimeve të elementeve vijore me prerje tërthore elementare të ekspozuara ndaj llojeve të ndryshme të ngarkesave. Dimensionimi i prerjeve tërthore homogjene sipas teorisë së sforcimeve të lejuara.

- **Dizajn studio I**

Qëllimi i lëndës: Mësimi i hapësirës nëpërmjet: procesit të perceptimit, të kuptuarit dhe analizës së hapësirës arkitektonike, procesit të imagjinimit, njohjes së elementeve përbërëse dhe kontekstit të projektit arkitektonik, elementeve të teorisë së arkitekturës, historisë dhe kulturës arkitektonike, njohurive dhe praktikës për paraqitjen e hapësirës arkitektonike.

- **Punim diplome**

Punimi i diplomës paraqet sublimim të diturive të nxëna gjatë studimeve. Bëhet fjalë për program konkret projektues në kontekst konkret fizik. Zgjidhja e propozuar e problemit real projektues duhet të jetë inovative dhe të përbëhet nga tërësi harmonike, teorike dhe praktike. Ky punim ka për qëllim t'a nxisë hulumtimin dhe gjetjen e shprehjes personale projektuese, si dhe mënyrën e komunikimit dhe prezantimin e projektit konkret si tërësi.

- **Dizajn studio II**

Qëllimi kryesor i lëndës është t'u mundësojë studentëve të analizojnë dhe paraqesin në mënyrë diagramike karakteristikat e një vendi të caktuar - subjekt i interesit kërkimor. T'i kuptojnë, si dhe të mësojnë t'i zbatojnë ato në fazat e ndryshme të procesit krijues, të menduarit për një projekt arkitektonik. T'u mundësojë studentëve të analizojnë një program të caktuar, nga i cili më vonë duhet të zhvillojnë një koncept të qartë arkitektonik. Të krijojnë kuptim se si dizajni i formës dhe hapësirës arkitektonike lidhet drejtpërdrejtë me nevojat psikologjike, fiziologjike, sociologjike dhe kulturore të njerëzve. Të mësojnë më shumë teknika të ndryshme të kërkimit të strategjive të tyre të projektit (përmes skicimit, diagramit dhe krijimit të modeleve studimore analoge dhe digjitale). Të mësojnë të përgatisin forma të ndryshme të vizatimeve dhe modeleve të prezantimit përmes të cilave do të prezantojnë projektin përfundimtar.

Lëndë zgjedhore

- **Албански јазик за почетници 1**

Lënda Gjuhë Shqipe për Fillestarë 1 dhe 2, është e përgatitur me qëllim që studentëve, të cilët nuk kanë njohuri themelore mbi gjuhën shqipe, t'u mundësojë të njihen me karakteristikat (veçoritë) e kësaj gjuhe, të fitojnë njohuri

mbi strukturën gjuhësore të kësaj gjuhe, t'i zgjerojnë dhe t'i përdorin njohuritë e tyre në situata të përditshme, me ndihmën e të cilave në të njëjtën kohë, do të fitojnë njohuri mbi strukturën e gjuhës. Gjithashtu, do të jenë të aftë të fitojnë një fond modest të kategorive të ndryshme leksikore-gramatikore, të cilat do t'u mundësojnë biseda (konverzacione), të thjeshta.

- **Gjuhë shqipe për fillestarë 2**

Lënda Gjuhë Shqipe për Fillestarë 1 dhe 2, është e përgatitur me qëllim që studentëve, të cilët nuk kanë njohuri themelore mbi gjuhën shqipe, t'u mundësojë të njihen me karakteristikat (veçoritë) e kësaj gjuhe, të fitojnë njohuri mbi strukturën gjuhësore të kësaj gjuhe, t'i zgjerojnë dhe t'i përdorin njohuritë e tyre në situata të përditshme, me ndihmën e të cilave në të njëjtën kohë, do të fitojnë njohuri mbi strukturën e gjuhës. Gjithashtu, do të jenë të aftë të fitojnë një fond modest të kategorive të ndryshme leksikore-gramatikore, të cilat do t'u mundësojnë biseda (konverzacione), të thjeshta.

- **Gjuhë maqedonase për fillestarë 1**

Programi për Gjuhën Maqedonase për Fillestarë 1, përfshinë: të lexuarit, të shkruarit, të dëgjuarit dhe të folurit. Përmes ushtrimeve të veçanta dhe ligjëratave u mundësohet studentëve ta njohin komunikimin bazë në gjuhën maqedonase, d.m.th, të njoftuarit, përshëndetjet, prezantimin, si dhe pasurimin e fondit të fjalëve bashkë me të shkruarit dhe të kuptuarit të teksteve të vogla. Në përpilimin e programit është marrë parasysh që njohuritë e fituara nga ana e studentëve të mund të zbatohen edhe më tutje. Materiali përpunohet sipas parimit të ligjëratave dhe ushtrimeve të kombinuara, si dhe detyrave të vazhdueshme përmes, të cilave studentët përfshihen në mënyrë aktive gjatë orës mësimore duke parashtruar pyetje dhe propozime për mbarëvajtjen e orës.

- **Gjuhë maqedonase për fillestarë 2**

Lënda Gjuhë Maqedonase për Fillestarë 2, përfshinë: të lexuarit, të shkruarit, të dëgjuarit dhe të folurit. Në suaza të kësaj lënde përfshihen gjerat në vijim: detyra të përditshme, planifikimi i aktiviteteve për periudhën e ardhshme, përshkrimi i personave, vendeve dhe lëndëve. Në përpilimin e programit është marrë parasysh, që njohuritë e fituara nga ana e studentëve të mund të zbatohen edhe më tutje.

- **Gjuhë maqedonase niveli i mesëm 1**

Lënda Gjuhë Maqedonase - Niveli i Mesëm 1, përfshinë: leximin, shkrimin, dëgjimin dhe të folurit nëpërmjet të cilit studentët: do ta pasurojnë fjalorin përmes teksteve të përshtatshme për aktivitetet e përditshme (në një bankë, në bibliotekë, në ministri, etj.) dhe do të përmirësojnë shkathtësitë për shkrimin profesional dhe të folurit që janë të nevojshëm për komunikim të qartë dhe efektiv në karrierën e tyre të mëtejshme profesionale. Një theks i veçantë dhe i vazhdueshëm mbi aktivitetin e përgjithshëm është vendosur në elementet gjuhësorë, domethënë në drejtshkrimin dhe gramatikën e gjuhës standarde maqedonase. Ekspertët, si një nga elementët kyç për shprehjen e mirë me shkrim e përcaktojnë përdorimin korrekt të gjuhës.

- **Gjuhë maqedonase niveli i mesëm 2**

Lënda Gjuhë Maqedonase - Niveli i Mesëm 2, përfshinë: leximin, shkrimin, dëgjimin dhe të folurit. Theks i veçantë vihet në zhvillimin e aftësive të komunikimit të studentëve, ose përdorimin e gjuhës në aktivitetet e përditshme dhe kontekstin profesional, duke pasuruar fjalorin dhe duke fituar njohuri për strukturën dhe llojet e teksteve profesionale. Do të përfshihen stile të ndryshme të komunikimit, me qëllim që studentët të krijojnë komunikim të mirë me publikun përmes teksteve të tyre dhe të tërheqin dhe mbajnë vëmendjen e tyre.

- **Gjuhë maqedonase për qëllime profesionale 1**

Pas përfundimit të lëndës Gjuhë Maqedonase për Qëllime Profesionale 1, nga studentët pritet t'i zgjerojnë dhe t'i forcojnë aftësitë e tyre për shprehje më të avancuar me shkrim dhe me gojë në maqedonisht në kontekstin e mjediseve të ndryshme profesionale. Studentët, pritet të jenë në gjendje të lexojnë, të shkruajnë dhe të kuptojnë tekste të ndryshme profesionale në maqedonisht. Ata, gjithashtu pritet të fitojnë njohuri dhe aftësi në lidhje me terminologjinë e përgjithshme nga fusha e drejtësisë, biznesit dhe ekonomisë, administratës, shkencave kompjuterike, gjuhës dhe komunikimit dhe të jenë në gjendje ta përdorin atë terminologji në korniza të profesioneve të tyre të ardhshme. Përveç përmblotjes së këtyre qëllimeve profesionale, studentët pritet të bëhen më autonomë në mësimin e gjuhës dhe të jenë në gjendje të mendojnë në mënyrë kritike në një ambient shumëgjuhësor dhe shumëkulturore.

- **Gjuhë maqedonase për qëllime profesionale 2**

Pas përfundimit të lëndës Gjuhë Maqedonase për Qëllime Profesionale 2, nga studentët pritet t'i rikonfirmojnë dhe t'i zgjerojnë më tej aftësitë e tyre për shprehje të avancuar me shkrim dhe me gojë në maqedonisht në kontekstin e profesioneve të tyre të ardhshme. Ata, do të jenë në gjendje të lexojnë, shkruajnë dhe të kuptojnë lloje të ndryshme të teksteve profesionale në maqedonisht, të analizojnë dhe t'i diskutojnë këto tekste, si dhe t'i krijojnë dokumentet e

tyre, duke përfshirë biografi profesionale në maqedonisht (CV). Ata, gjithashtu duhet t'i zgjerojnë njohuritë e terminologjisë specifike nga fusha e drejtësisë, biznesit dhe ekonomisë, administratës, shkencave kompjuterike, gjuhëve dhe komunikimit dhe të jenë në gjendje ta përdorin atë terminologji në simulimin e situatave autentike nga mjediset profesionale në debate dhe në shkëmbim mendimesh në lidhje me aspektet e ndryshme të këtyre profesioneve.

• Gjuhë Angleze 1

Pas përfundimit të secilit nivel të kësaj lënde, që përcaktohet sipas testit për përcaktim të nivelit në fillim të semestrit/vitit, prej studentëve pritet të jenë në nivel të ndryshëm sipas Kornizës Gjuhësore Evropiane dhe të mund të kuptojnë dhe përdorin fraza dhe shprehje të ndryshme për nevojat e tyre siç janë: pyetje dhe përgjigje për veten dhe familjen, për jetën e tyre, për kohën e lirë, financat, për diploma universitare, për shkathtësi të punës, për avancimin e tyre personal, për profesionin e tyre të ardhshëm dhe të ngjashme, të marrin pjesë në dialogë dhe debate dhe të shkruajnë paragrafë, apo ese për tema që i kanë përpunuar. Pas përfundimit të lëndës, prej studentëve pritet të jenë në nivelin A1, sipas Kornizës Gjuhësore Evropiane. Ata, duhet të jenë në gjendje t'i kuptojnë dhe përdorin në mënyrë të drejtë shprehjet themelore në lidhje me kërkesat konkrete, të pyesin dhe përgjigjen në lidhje me pyetjet për identitetin personal dhe marrëdhëniet, të prezantojnë veten dhe të tjerët duke përdorur përemrat vektorë dhe pronorë, të përshëndeten, të përdorin fjalor të saktë për objektet në klasë, të bëjnë dallim në mes të njëjësit dhe shumës, të njohin dhe të përdorin numrat prej 1 - 100. Gjithashtu, studentët duhet të jenë në gjendje të përshkruajnë një ditë të zakonshme me përdorim të strukturave më të thjeshta gjuhësore, të shkruajnë dhe të flasin për jetën e tyre dhe kohën e lirë. Ata, duhet të njohin dhe përdorin në mënyrë të drejtë fjalorin në lidhje me kategoritë e ushqimeve dhe pijeve, muajt e vitit, të bëjnë kërkesa në mënyrë të sjellshme, të përshkruajnë vende, të zgjedhin një destinacion dhe të japin udhëzime, të flasin për gjërat që u pëlqejnë dhe nuk u pëlqejnë.

• Gjuhë Angleze 2

Pas përfundimit të secilit nivel të kësaj lënde që përcaktohet sipas testit për përcaktim të nivelit në fillim të semestrit/vitit, prej studentëve pritet të jenë në nivel të ndryshëm sipas Kornizës Gjuhësore Evropiane dhe të mund të kuptojnë dhe përdorin fraza dhe shprehje të ndryshme për nevojat e tyre, siç janë: pyetje dhe përgjigje për veten dhe familjen, për jetën e tyre, për kohën e lirë, financa, për diploma universitare, për shkathtësi pune, për avancimet e tyre personale, për profesionin e tyre të ardhshëm dhe të ngjashme, të marrin pjesë në dialogë dhe debate dhe të shkruajnë paragrafë ose ese për tema që i kanë përpunuar. Pas përfundimit të lëndës prej studentëve pritet të jenë në nivelin A1, sipas Kornizës Gjuhësore Evropiane. Ata, duhet të jenë në gjendje t'i kuptojnë dhe përdorin në mënyrë të drejtë shprehjet themelore në lidhje me kërkesat konkrete, të pyesin dhe përgjigjen në lidhje me pyetjet për identitetin personal dhe marrëdhëniet, të prezantojnë veten dhe të tjerët duke përdorur përemrat vektorë dhe pronorë, të përshëndeten, të përdorin fjalor të saktë për objektet në klasë, të bëjnë dallim në mes të njëjësit dhe shumës, të njohin dhe të përdorin numrat prej 1 - 100. Gjithashtu, studentët duhet të jenë në gjendje të përshkruajnë një ditë të zakonshme me përdorim të strukturave më të thjeshta gjuhësore, të shkruajnë dhe të flasin për jetën e tyre dhe kohën e lirë. Ata, duhet ta njohin dhe përdorin në mënyrë të drejtë fjalorin në lidhje me kategoritë e ushqimeve dhe pijeve, muajt e vitit, të bëjnë kërkesa në mënyrë të sjellshme, të përshkruajnë vende, të zgjedhin një destinacion dhe të japin udhëzime, të flasin për gjërat që u pëlqejnë dhe nuk u pëlqejnë.

• Gjuhë Angleze 3

Pas përfundimit të secilit nivel të kësaj lënde, që përcaktohet sipas testit për përcaktim të nivelit, në fillim të semestrit/vitit, prej studentëve pritet të jenë në nivel të ndryshëm sipas Kornizës Gjuhësore Evropiane dhe duhet të jenë në gjendje të kuptojnë dhe përdorin shprehje dhe fraza të njohura që kanë për qëllim përmbushjen e nevojave të një tipi real: të pyesin dhe tu përgjigjen pyetjeve për fenomene të ndryshme, duke përfshirë krimin dhe katastrofat natyrore, të ftojnë dhe tu përgjigjen ftesave, të lexojnë dhe dëgjojnë thelbin, detajin dhe të kuptojnë, të vlerësojnë përparimin e tyre personal, të marrin pjesë në role dhe dialogë për tema të njohura dhe të prodhojnë një paragraf/ese për temat në lidhje me temat e materialit të lëndës. Në fund të lëndës studentët pritet të jenë në nivelin B1, të Kornizës së Përbashkët Evropiane. Ata, duhet të jenë në gjendje të pyesin pyetje dhe të përgjigjen për gradat universitare, shkathtësitë e punës dhe situatat, të ftojnë dhe tu përgjigjen ftesave. Studentët, duhet të jenë në gjendje të pyesin dhe të përshkruajnë marrëdhëniet familjare dhe gjendjen martesore dhe duhet të jenë në gjendje të njohin dhe përdorin në mënyrë të përshtatshme fjalorin në lidhje me gradat universitare dhe arsimin universitar, artin, udhëtimin dhe sportin.

• Gjuhë Angleze 4

Pas përfundimit të secilit nivel të kësaj lënde që përcaktohet sipas testit për përcaktim të nivelit në fillim të semestrit/vitit, prej studentëve pritet të jenë në nivel të ndryshëm sipas Kornizës Gjuhësore Evropiane dhe duhet të jenë në gjendje të kuptojnë dhe përdorin shprehje dhe fraza të njohura që kanë për qëllim përmbushjen e nevojave të një tipi real; të pyesin dhe të japin përgjigje për identifikim personal dhe marrëdhënie personale; të flasin dhe shkruajnë për jetën e tyre të përditshme, kohën e lirë, argëtimin, mjedisin e financave, problemet; të jenë në gjendje

të pyesin pyetje dhe të përgjigjen për gradat universitare, shkathtësitë e punës dhe situatat. Pas përfundimit të lëndës, studentët pritet të jenë në nivelin B2, të Kornizës së Përbashkët Evropiane. Ata, pritet të jenë përdorues të pavarur të gjuhës angleze dhe të mundën të zbatojnë disa nga funksionet gjuhësore të mëposhtme: të japin këshilla; të pyesin pyetje dhe të përgjigjen për gradat universitare, shkathtësitë e punës dhe situatat; të ftojnë dhe tu përgjigjen ftesave, të lexojnë dhe dëgjojnë thelbin, detajin dhe të kuptojnë.

- **Gjuhë Angleze 5**

Gjuha Angleze për Qëllime Akademike është lëndë me kohëzgjatje prej një semestri. Qëllimet e lëndës janë t'u mundësojë studentëve të fitojnë aftësi, të cilat do ta ndihmojnë mësimnxënien e tyre gjuhësore dhe përparimin e tyre gjuhësor në një mjedis akademik të mësimnxënies dhe mësimdhënies. Lënda, duhet t'i aftësojë të përdorin këta aftësi edhe në orë të gjuhës së huaj, si edhe në përparimin akademik në fushat e përmbytjes. Ajo, përfshinë aftësi gjuhësore, studiuese dhe në përgjithësi aftësi zbatuese (dëgjim, dhënie të prezantimeve me gojë, argumente konstruktive), në detyra të veçanta. Për këtë arsye, pas përfundimit të suksesshëm të lëndës, niveli i zotësisë së gjuhës duhet të jetë në nivelin C1, sipas Kornizës së Përbashkët Evropiane. Si rezultat, studentët duhet të jenë në gjendje të prezantojnë në mënyrë të suksesshme prezantime orale, të marrin pjesë në tribuna të debateve/diskutimeve online, duke shprehur mendimet dhe argumentet e tyre dhe tu japin të tjerëve informacion kthyes në mënyrë konstruktive. Përveç kësaj, studentët duhet të jenë në gjendje të dëgjojnë dhe lexojnë thelbin dhe të shkruajnë një paragraf dhe ese argumentues duke shprehur mendimet e tyre. Ata, duhet të shkruajnë një paragraf dhe ese që zgjidh problemin. Ata, duhet të jenë në gjendje të prezantojnë informacion pamor në formën e prezantimit poster në Power Point. Studentët duhet të jenë në gjendje të identifikojnë idetë kryesore dhe faktet mbështetëse në një tekst dhe të analizojnë dhe identifikojnë fjalinë kryesore të temës në një paragraf. Ata, duhet të jenë në gjendje ta identifikojnë qëllimin e një teksti, modelet e organizimit në një tekst dhe të zbatojnë ata në shkrimet e tyre.

- **Kapituj të zgjedhur nga shkathtësitë e TI**

Qëllimi i kësaj lënde është: T'ua tregojë studentëve elementet teknike, strukturën e tekstit dhe dizajnin e punimeve të ndryshme gjatë studimeve. T'u mundësojë studentëve të fitojnë njohuri mbi shkathtësitë e TI, që do t'u duhen për përpunimin e punimeve shkencore, profesionale dhe prezantime. T'i aftësojë studentët për zbatimin praktik të shkathtësive të TI.

- **Microsoft Office Access**

Lënda Zyrtare Akademike e Microsoft (MOAC) për Aksesin 2016, ofron përvojën praktike për të rritur aftësitë tuaja personale të produktivitetit. Ky program, i ndarë në 15 mësimë, mbulon të gjitha fushat e produktit që kërkohet për të kaluar provimin MOS 77-730.

- **Microsoft Office Excel**

Lënda Zyrtare Akademike e Microsoft (MOAC), për Excel 2016, ofron përvojën praktike për të rritur aftësitë tuaja personale të produktivitetit. Ky program, i ndarë në 13 mësimë, mbulon të gjitha fushat e produktit që kërkohet për të kaluar provimin MOS 77-727

- **Microsoft Office PowerPoint**

Lënda Zyrtare Akademike e Microsoft (MOAC), për PowerPoint 2016, ofron përvojën praktike për të rritur aftësitë tuaja personale të produktivitetit. Ky program, është i ndarë në 11 burime mësimore dhe mbulon të gjitha fushat e produktit të kërkuara për të kaluar provimin MOS 77-729.

- **Microsoft Office Word**

Lënda Zyrtare Akademike e Microsoft (MOAC), për Word 2016, ofron përvojën praktike për të rritur aftësitë tuaja personale të produktivitetit. Ky program është i ndarë në 11 burime mësimore dhe mbulon të gjitha fushat e produktit të kërkuara për të kaluar provimin MOS 77-725.

- **Krijimi i ueb-it**

Qëllimi i lëndës është zhvillimi i një ueb faqe të thjeshtë bazuar në standardet aktuale. Kërkon njohuri të gjuhës Hypertext Markup Language (HTML) dhe Cascading Style Sheets(CSS). Shumica e ueb faqeve përdorin imazhe në formë të banerave, logove, imazheve, ose skanimeve. Adobe Fireworks është ndërtuar si një mjet për të krijuar dhe manipuluar imazhet e dizajnuara për ueb dhe për tu lejuar krijuesve të zgjedhin këto imazhe në mënyrë që të zvogëlojnë madhësinë e skedarit. Fireworks, gjithashtu, mundëson integrim të shkëlqyer me Dreamweaver. Kjo lëndë ofron një seri aktivitete që mundësojnë një hyrje gjithëpërfshirëse në HTML, CSS dhe krijimin e imazheve për ueb.

- **Dizajnimi i medimeve digjitale**

Qëllimi i lëndës është të dizajnojë dhe përpunojë grafika raster dhe vektoriale përmes programeve kryesore, siç janë:

Adobe Photoshop dhe Illustrator, si dhe projektimin dhe botimin e materialeve komerciale për shtyp, duke përdorur Adobe In Design.

- **Google aplikacione për edukim**

Përmbledhje konceptuale me udhëzime praktike për shfrytëzimin e potencialit arsimor të G Suite. Kjo i identifikon parimet e të mësuarit që e mundësojnë përdorimin efektiv të G Suite për të krijuar mjedise mësimore që rrisin komunikimin arsimor. Lënda është e organizuar në një seri modulesh. Modulet janë të bashkangjitur në një meni përmbledhëse, të cilat mund të qasen në faqen "Google" për edukim, e cila i organizon modulet me po të njëjtën radhitje me të cilën do të diskutohen në klasë.

- **Bazat e harduerit dhe softuerit të TI**

Pas përfundimit të lëndës studentët do të jenë në gjendje të përshkruajnë komponentët e brendshëm të një kompjuteri, të montojnë një sistem kompjuterik, të instalojnë një sistem operativ dhe të zgjidhin problemet duke përdorur mjetet e sistemit dhe softuerin diagnostikues. Studentët gjithashtu do të jenë në gjendje të përdorin një sërë aplikacionesh dhe mjetesh TIK, të hulumtojnë në internet dhe të adresojnë sigurinë dhe etikën e sistemeve të informacionit dhe çështjet e krimit kibernetik.

- **Hyrje në sigurinë kibernetike**

Lënda do të mbulojë aspektet më të rëndësishme të qëndrimit të sigurt në internet, duke ofruar njohuri që studentët të kenë një kuptim më të mirë të sigurisë në internet dhe të fillojnë të mbrojnë jetën e tyre digjitale, qoftë në shtëpi apo në shkollë. Njohja e kërcënimeve që mund të dëmtojnë në internet është po aq e rëndësishme sa hapat që mund të ndërmerren për të parandaluar këto kërcënime. Lënda do të ofrojë gjithashtu përkufizime, informacione të detajuara, duke përfshirë viruset dhe trojanët, si dhe koncepte të tilla si siguria e rrjetit, kriptografia, vjedhja e identitetit dhe menaxhimi i rrezikut.

- **Anglishtja për Teknologjinë e Informacionit 1**

Kjo lëndë ofrohet me qëllim të përmirësimit të katër shkathtësive kryesore të gjuhës, siç janë: leximi, shkrimi, dëgjimi dhe të folurit në fushën specifike të përmbajtjes, si dhe rishikimi dhe avancimi i artikujve dhe fjalorit të përzgjedhur në nivel të mesëm dhe të mesëm të lartë në fushën e shkencave kompjuterike dhe teknologjitet. Kjo është bërë për t'u mundësuar studentëve të kuptojnë tekste më të komplikuar në këtë fushë dhe u mundësojnë atyre të komunikojnë me rrjedhshmëri me kolegët dhe ekspertët e fushës. Vëmendje e veçantë i kushtohet përdorimit të materialeve autentike për të ndjekur trendet dhe arritjet e fundit në këtë fushë.

- **Anglishtja për Teknologjinë e Informacionit 2**

Kjo lëndë ofrohet me qëllim të përmirësimit të katër shkathtësive kryesore të gjuhës, siç janë: leximi, shkrimi, dëgjimi dhe të folurit në fushën specifike të përmbajtjes, si dhe rishikimi dhe avancimi i artikujve dhe fjalorit të përzgjedhur në nivel të mesëm dhe të mesëm të lartë në fushën e shkencave kompjuterike dhe teknologjitet. Kjo është bërë për t'u mundësuar studentëve të kuptojnë tekste më të komplikuar në këtë fushë dhe u mundësojnë atyre të komunikojnë me rrjedhshmëri me kolegët dhe ekspertët e fushës. Vëmendje e veçantë i kushtohet përdorimit të materialeve autentike për të ndjekur trendet dhe arritjet e fundit në këtë fushë.

- **Hyrje në Administrimin Publik**

Administrata publike paraqet një fushë të veçantë me interes shkencor. Lënda: Hyrje në Administrimin Publik duhet t'u ofrojë studentëve njohuri mbi konceptet themelore të administratës publike. Kujdes i posaçëm do t'i kushtohet ofrimit të njohurive për evoluimin e administratës publike, si dhe të reformave të parapara të administratës publike në vendin tonë. Gjithashtu, studentët do të kenë mundësi të njoftohen dhe në mënyrë kritike ta analizojnë zhvillimin dhe fenomenet në administratën publike. Meqë lëmi i studimit është objekt i ndryshimit të pandërprerë, kujdes i veçantë do t'u kushtohet zhvillimeve të reja si dhe teorive klasike të studimit të administratës publike. Materia hulumtuese e kësaj lënde konsiston në: përkufizimet dhe njohuritë themelore për parimet dhe institucionet e administratës publike, rolin dhe rëndësinë e administratës publike në shoqërinë e organizuar, gjenezën dhe zhvillimin historik të administratës publike, strukturat organizative të administratës publike, funksionimin e institucioneve të administratës publike, shërbimet e administratës publike, vendimmarrjen në AP.

- **Lidershipi Publik dhe Zhvillimi Organizativ**

Kjo lëndë ka për qëllim t'i njoftojë studentët me mënyrën se si liderët dhe udhëheqësit i zhvillojnë dhe si i zbatojnë arritjet e misionit dhe vizionit në një organizatë të dhënë në sektorin publik; zhvillimin e vlerave të nevojshme për

sukses afatgjatë dhe zbatimin e tyre nëpërmjet aktiviteteve dhe shprehive të përshtatshme; si liderët dhe udhëheqësit janë personalisht të përfshirë në sigurimin, që sistemet e menaxhimit të sigurisë, do të zhvillohen dhe zbatohen. Gjithashtu, i njofton për mënyrën se si organizata e realizon misionin dhe vizionin e saj përmes një strategjie të qartë të bazuar në pikëpamjet e të gjitha palëve të interesuara, të mbështetur nga të gjitha politikat relevante, planet, qëllimet dhe proceset.

- **Hyrje në Politikat Publike**

Lënda ka për qëllim t'u mundësojë studentëve që t'i kuptojnë më lehtë politikat publike, parimet për krijimin e tyre, udhëheqjen e një politike konkrete, analizën, implementimin, vlerësimin dhe zhvillimin e saj. Menaxhimi i politikave publike është disiplinë për zgjidhjen e problemeve të cilat rezultojnë në njohuri nga metodologjitë dhe teoritë themelore të shkencave sociale, të profesioneve sociale dhe të filozofisë së politikave.

- **Fillet e së Drejtës**

Qëllimi i programit të lëndës: Studentët të pajisen me njohuri themelore për shtetin dhe të drejtën; Aftësimi i studentëve për formësimin teorik të formave të ndryshme të shtetit; Vështrimi kritik i së drejtës si një fenomen shoqëror; Inkurajimi i vështrimit analitik të studentët për problemet me të cilat sot ndeshet shteti dhe e drejta në kushtet e globalizimit dhe integriteteve evropiane; Në fund të lëndës studentët do të jenë në gjendje të dallojnë format themelore të shtetit dhe së drejtës; T'i shpjegojnë konceptet themelore për shtetin dhe të drejtën dhe ndërlidhjen e tyre me jetën praktike; T'i fitojnë njohuritë themelore, hyrëse dhe të përgjithshme për shtetin dhe të drejtën të cilat do të jenë doemos të nevojshme për studime të mëtejshme në shkencat bazale juridike.

- **Hyrje në kriminalistikë**

Përmes kësaj lënde studentët do të fitojnë njohuri të thelluara nga kriminalistika. Kjo disiplinë, në kuptimin e gjerë të fjalës, kontribuon në luftën kundër kriminalitetit përmes zbulimit dhe parandalimit të tij. Kjo lëndë mësimore do të përpunohet në mënyrë teorike dhe praktike (përmes konsultimeve, literaturës së propozuar, debateve dhe diskutimeve me studentët). Qëllimi i këtij programi është përgatitja dhe aftësimi i studentëve për përdorimin e mjeteve dhe metodave kriminalistike që përdoren për zbulimin dhe sqarimin e veprave penale si dhe për parandalimin e kriminalitetit.

- **E drejta e punës**

Studimi i lëndës E Drejta e Punës studentëve do t'u mundësojë: - të njihen me korpusin e çështjeve dhe problemeve të cilat janë pjesë përbërëse e së drejtës së punës, duke u nisur nga premisa fundamntale se secili nga ne një ditë do të themelojë marrëdhënie pune dhe pikërisht për atë arsye njohja e të drejtave nga marrëdhënia e punës paraqet edhe një mori çështjesh në luftën për jetë më cilësore; - të njihen me aspektet e ndryshme të realizimit të të drejtave, detyrimeve dhe përgjegjësisë nga marrëdhënia e punës, si dhe me institucionet juridike nga lëmi i punës; - t'i studiojnë marrëdhëniet e punës në praktikë përmes – procedurës së punësimit, lidhjen e kontratës për punësim, realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave nga marrëdhënia e punës te punëdhënësi dhe organet kompetente; procedurën e përgjegjësisë së të punësuarve; pushimin e marrëdhënies së punës, përkatësisht pushimin e vlefshmërisë së kontratës për punësim; - të përpunojnë aktet konkrete në lidhje me të gjitha institutet të cilat janë përfshirë me rregullativën ligjore pozitive nga lëmi i marrëdhënieve të punës në RMV; - të mundësohen forma të ndryshme të pjesëmarrjes së studentëve dhe të inkorporohet mundësia për përvetësimin e numrit sa më të madh të mundshëm të poenave të parashikuara për aktivitetin.

- **Liritë dhe të Drejtat e Njeriut**

Lufta për të drejtat e njeriut fillon me përpjekjet historike për t'i identifikuar ato. Me kalimin e kohës, korpusi i të drejtave dhe lirive të njeriut që mbrohen me ligje dhe marrëveshje ndërkombëtare është zgjeruar, por kjo nuk do të thotë se ato respektohen në praktikë. Në fillim, të drejtat e njeriut konsideroheshin si çështje të brendshme të shteteve (sipas parimit të sovranitetit absolut të shtetit) dhe vetëm në kohërat më të reja ato fituan statusin e normave kogente. Kjo lëndë e studion zhvillimin e doktrinës për të drejtat e njeriut, llojet dhe kategoritë e të drejtave të njeriut dhe dokumentet kryesore që i rregullojnë dhe që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut. Kjo lëndë ka për qëllim: t'i njoftojë studentët me konceptin e të drejtave ndërkombëtare të njeriut, me zbatimin e tyre dhe me ndikimin që ato kanë në formulimin e politikave kombëtare. Kjo do t'i inkurajojë studentët të reflektojnë në mënyrë kritike mbi raportin mes të drejtës ndërkombëtare dhe të asaj kombëtare, do t'i vetëdijësojë ata për ndryshimet ndërkombëtare në këtë drejtim dhe për mënyrën se si këto të drejta ndikojnë në jetën e njerëzve në botë. Lënda do t'i nxisë që të kontribuojnë në përparimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

- **Shkrimi dhe Arsyetimi Ligjor**

Qëllimi i lëndës është që të ofrojë njohuritë themelore të shkrimit dhe arsyetimit juridik studentëve të vitit të parë. Në këtë lëndë, do të përfitohen njohuritë e shkrimit dhe arsyetimit juridik, parimet dhe udhëzimet themelore për të, duke zbatuar metodat e ndryshme të shkrimit juridik të akteve juridike normative (rregulloret, ligjet, vendimet, aktgjykimet,

kontratat, testamentet, etj) dhe të akteve juridike jonormative (CV, kërkesa, konkursi, aplikimi, njoftimi, padia, etj).

- **Teknologjia Reproductive e Asistuar dhe e Drejta**

Kjo lëndë ka për qëllim të theksoj faktin se në shoqërinë bashkëkohore, tanimë nuk ekziston një model universal i familjes dhe prindërisë. Me studimin e lëndës 'Teknologjia Reproductive e Asistuar dhe e Drejta', studentët do të fitojnë njohuri rreth teknologjive të reja për riprodhimin artificial, të cilët janë pjesë e politikës bashkëkohore të natalitetit. Studentët, në detaje do të mësojnë për të gjitha metodat e reja të riprodhimit të qenies njerëzore, duke përfshirë: inseminimin artificial, in-vitro fertilizimi, amësia surrogate, lindja e fëmijës nga një grua me spermë të donuar, riprodhimi post human, ko-prindëria (bashkëprindëria), ngjizja e fëmijës nga tre persona, krioprezervimi i gameteve ose embrioneve. Nëpërmjet kësaj lënde, studentët do të njoftohen se ekzistojnë edhe forma tjera, të cilat shkenca i ofron, por ende konsiderohen procese të ndaluara: klonimi, zgjedhja e gjinisë së fëmijës, përmirësimi i kapaciteteve fizike, intelektuale të fëmijës së ardhshëm (eugenika), etj. Përmes studimit të kësaj lënde, pritët nga studentët, që ta zhvillojnë mendimin e tyre kritik me anë të debateve për dilemat e shumta morale, etike dhe juridike lidhur me këto teknologji të reja për riprodhimin e qenies njerëzore.

- **Dhuna në Familje**

Dhuna në familje është një fenomen shoqëror me përmasa dhe shtrirje të gjerë edhe në shoqërinë bashkëkohore. Ajo, është e pranishme në të gjitha shtetet e shoqëritë, pavarësisht zhvillimit dhe emancipimit të tyre. Imunë ndaj këtij fenomeni nuk është as vendi ynë e as rajoni në të cilin jetojmë. Andaj, studentët e drejtësisë përmes kësaj lënde fitojnë njohuri rreth asaj se çfarë është dhuna në familje, format në të cilat ajo manifestohet, rregullimet ligjore në vend, rajon dhe në sferën ndërkombëtare, si dhe mënyrat e parandalimit të saj. Përmes kësaj lënde, studentët në fund të lëndës, do të jenë në gjendje ta identifikojnë dhunën në familje, t'i identifikojnë veprat penale që inkriminohen në Kodin Penal si dhunë në familje, si dhe të zhvillojnë mendim kritik rreth kësaj problematike. Kjo lëndë e aftëson juristin e ardhshëm që gjatë ushtrimit të profesionit të tij si gjykatës, prokuror apo avokat t'i trajtojë në mënyrë sa më adekuate çështjet nga kjo sferë që kanë ndjeshmëri të lartë, si dhe të ofrojnë ndihmë dhe mbrojtje sa më adekuate për viktimat e këtyre veprave penale.

- **Hyrje në Shkenca Kompjuterike**

Kjo lëndë paraqet një hyrje të gjerë dhe të integruar në konceptet themelore të shkencave kompjuterike. Lënda mbulon tema, siç janë: historia e llogaritjes; logjika dhe sistemet digjitale; hyrje në arkitekturën kompjuterike, algoritme të thjeshta, zgjidhje problemesh dhe struktura të të dhënave; hyrje në gjuhët e programimit, sistemet operative, bazat e të dhënave, rrjetat, inxhinieria e softuerit dhe ueb-it; llojet e aplikacioneve, përfshirë edhe përshkrimin e disa programeve specifike (procesorë teksti, baza të dhënash, shfletues, etj.); procedimi i të dhënave tradicionale dhe multimediale.

- **Teknologjitë e Internetit**

Qëllimi kryesor i lëndës është që t'u jep studentëve njohuri praktike mbi mekanizmat themelorë, shërbimet dhe protokollet e rrjetit global - Internetit. Lënda ofron mësimin e arkitekturës së përgjithshme të uebfaqeve efikase, skalabile dhe të sigurta. Studentët, do të fitojnë njohuri të thella teknike të XML, XHTML (listat, tabelat, figurat, multimedia dhe formularët), CSS (formatimi, stilet dhe layout-i), si dhe JavaScript (variablat, kushtet, ciklet dhe funksionet).

- **Probabiliteti dhe Statistika e Zbatuar**

Qëllimi i kësaj lënde është t'i pajisë studentët me njohuritë themelore nga probabiliteti dhe statistika që kanë zbatim të drejtpërdrejtë në fushën e shkencave kompjuterike. Qëllimi është që të mësohet se si bëhet përpunimi i të dhënave statistikore, ligjshmëritë e tyre, paraqitja e tyre, ligjet për dhënie e konkluzioneve përkatëse bazuar në të dhënat e përpunuara, etj. Po ashtu, qëllimi është që të mësohen parimet themelore nga fusha e probabilitetit dhe se si mund të zbatohen ato parime në fushat e ndryshme nga jeta e përditshme posaçërisht në lëmin e shkencave kompjuterike.

- **E-Tregtia**

Lënda ka për qëllim t'i mësojë studentët me konceptet themelore dhe me terminologjinë e e-tregtisë (e-commerce): historinë e e-tregtisë e-botën: e-biznesin dhe e-tregtinë modelet e biznesit për e-tregtinë sistemet e pagesave online marketingun online e-infrastrukturat. T'u mësojë teknologjitë kryesore, të cilat janë të detyrueshme për të drejtuar e-tregtinë në ditët e sotme, duke përfshirë: shërbyesit (serverët), aplikacionet (software), lidhjet e internetit, portat e pagesës dhe sigurinë e tyre, "cookies", etj. Të bëhet aplikimi i konceptit "e-commerce" nga teoria në praktikë, duke bërë analizë të duhur në modelet e biznesit dhe teknologjive, si dhe marrjen e vendimeve në zgjidhjet më të përshtatshme. Të sqarohet kuptimi i procesit të krijimit të një dyqani ueb dhe lidhja e tij me sistemet e pagesës (porta pagese / payment gateway). Studenti të jetë në gjendje ta aplikojë këtë ide të e-biznesit në letër, të krijojë modelin e biznesit dhe të përgatisë financat. Studenti të jetë në gjendje t'i dallojë mjetet e ndryshme në internet për marketing dhe të jetë në gjendje të zbatojnë disa prej tyre në praktikë. Shqyrtimi mbi sigurinë e informacionit, etika dhe çështjet

sociale si dhe mënyrat për të trajtuar çështje të veçanta. Studenti të jetë i njohur me internet dhe "cloud" shërbimet.

- **Hyrje në Sistemet e Informacionit**

Qëllimet e kësaj lënde janë: - Të mësohen konceptet themelore dhe terminologjia e sistemeve të informacionit: - Konceptet themelore të sistemeve të informacionit: hardueri, softuerie, rrjetet; - E-World: e-biznes dhe e-commerce; - Zhvillimi i proceseve; - Të mësohen sistemet e informacionit dhe të teknologjive që përmirësojnë vlerat e biznesit dhe proceset e ndryshme brenda organizatave; - Aplikimi i IS koncepteve në disiplina të ndryshme drejtuese, gjatë analizës, interpretimit, vlerësimit dhe vendimeve; - Kuptimi i procesit të ridizajnit të organizatave duke përdorur sistemet e informacionit; - Përshkrimi i rolit të sistemeve të informacionit në vendimmarrje; - Shqyrtimi i sigurisë së informacionit, etikës dhe çështjeve sociale; - Njoftimi me internetin, tregtinë elektronike dhe e-biznesin; - Përgatitja e studenteve për të punuar në projekte të vogla, puna individuale apo grupe, të cilët nga natyra mund të bien në këto kategori: studimet e rastit, projektit kërkimor shkencor, projekte zhvillimore ose projekte praktike.

- **Etika Profesionale e TI**

Lënda siguron qasje gjithpërfshirëse në çështjet aktuale etike me rastin e shfrytëzimit të teknologjive të informacionit (TI). Vlerëson një sërë çështjesh të shtrura në vitet e kaluara dhe ato të tanishmet me të cilat ballafaqohen shfrytëzuesit e TI-së, duke filluar nga liria e të shprehurit, privatësia, pronësia intelektuale, hakerimi, dhe vazhdon me epokën e re, shfrytëzimin etik të rrjetave sociale dhe komunitetet online. Trajtohen dilemat etike dhe përgjegjësitë etike të profesionistëve të TI-së, si dhe promovohet vlerësimi kritik dhe shfrytëzimi i përgjegjshëm i TI-së.

- **Gjuhë Shqipe me Kulturë Shkrimi**

Lënda Gjuhë Shqipe me Kulturë Shkrimi është një sintezë e rregullave dhe udhëzimeve, të cilat janë të parapara për t'i përmirësuar shkathtësitë e të shprehurit me shkrim dhe me gojë në gjuhën shqipe. Përmirësimi i këtyre shkathtësive, para së gjithash, parashihet që të realizohet përmes familjarizimit me rregullat drejtshkrimore dhe disa norma morfologjike e sintaksore të gjuhës shqipe që shihen si të nevojshme që të arrihet përdorimi i drejtë i gjuhës. Më pas, theks i veçantë i kushtohet motivimit të studentëve për ligjërim të rrjedhshëm, rritjes së vetëdijes për përdorimin e gjuhës së pastër dhe standarde shqipe. Gjithashtu, hapësirë të veçantë zë edhe nxitja e vullnetit për përmirësim të procesit të të shkruarit, duke i vetëdijësuar studentët për dallimet e llojeve të teksteve të shkruara, por edhe për vetëdijen për integritet akademik në punimet serioze kërkimore (plagjiaturën), duke mos lënë pas as përfshirjen e terminologjisë specifike të fushave të ndryshme në të cilat janë të orientuara studentët. Të gjitha këto tema janë parapara që studentëve t'u ofrohen si njësi mësimore të kombinuara, gjegjësisht si rregulla, udhëzime e ushtrime që plotësohen mes veti.

- **Gjuhë Gjermane 1-4**

Me përfundimin e lëndës, nga studentët pritet që të kenë fituar njohuri të duhura në përputhje me Kornizën Evropiane të Gjuhëve (të përcaktuara saktësisht në nivele). Përveç kësaj, pritet që studentët të bëhen më të pavarur dhe më të përgjegjshëm ndaj mësimin të gjuhës. Deri në fund të lëndës, studentët do të jenë në gjendje që në mënyrë kritike të reflektojnë mbi tema të ndryshme dhe të japin përfundime. Studentët, gjithashtu do të jenë në gjendje t'i shprehin mendimet dhe opinionet e tyre në formë të shkruar dhe gojarisht në gjuhën gjermane.

- **Multikulturalizmi në Mësimdhënien e Gjuhës Angleze**

Qëllimet e programit të lëndës: Aftësi komunikimi: Studentët pritet të jenë në gjendje të prezantojnë opinionet e tyre në lidhje me kulturën dhe globalizimit dhe e gjithë kjo reflektohet në procesin e arsimimit. Pritet të diskutohen tema lidhur me tolerancën, mirëkuptimin, dhe akomodimin e diversitetit. Ata, gjithashtu, do të punojnë drejt përgatitjes të eseeve, ku do të trajtohen çështjet e relativizmit kulturor, stereotipeve, paragjytimeve, si dhe zhvillimi i koncepteve të bashkëpunimit ndërkulturor dhe arsimimit multikulturor. Aplikimi i njohurive dhe të kuptuarit: Krijimi i modeleve arsimore për bashkëpunim multikulturor dhe zbatimi i tyre në procesin e mësimdhënies së gjuhës angleze si gjuhë e dytë. Zhvillimi i një strategjie arsimore që do të tregohet e suksesshme në situata ku mund të ketë tensione në mesin e studentëve për shkak të mungesës së tolerancës. Aftësitë për të vlerësuar: Përpunimi i portofolit individual të bazuar në parimet e arsimimit multikulturor dhe kapacitetit, si dhe identifikimi i rasteve kur ka mungesë tolerancë, duke synuar zhvillimin e frymës së bashkëpunimit ndërkulturor. Njohuri dhe mirëkuptim: Njoftim me parimet themelore të kulturës, relativizmit kulturor, arsimimit ndërkulturor dhe multikulturor dhe adresimi i këtyre çështjeve në kuadrin e mësimdhënies së gjuhës angleze si gjuhë e huaj. Aftësitë e të mësuarit: Njoftim me modelet efikase për promovimin e multikulturalizmit në procesin arsimor, ku gjuha angleze do ta ketë rolin më të rëndësishëm, si gjuhë neutrale për studentët, pavarësisht nga përkatësia etnike.

- **Studime Ndërkulturore**

Pasi ta kenë përfunduar lëndën, studentët, do të mund t'i identifikojnë çështjet globale dhe problemet nga perspektiva e kulturave të ndryshme, dinamikën e komunikimit në kulturat tjera, ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet vlerave të tyre dhe ato të kulturave tjera, si dhe ngjashmëritë dhe dallimet e praktikave të komunikimit të tyre dhe të

kulturave tjera. Aq më shumë, nga studentët pritet që të bëhen më të vetëdijshëm për stereotipat që shoqëria i ka për kulturat e ndryshme dhe, si pasojë, më mirë do ta kuptojnë vendin e tyre në komunitetin global. Studentët, do të fillojnë të mendojnë në mënyrë kritike mbi tema rreth etnisë së tyre, identitetin gjinor, klasën, fenë, origjinën kombëtare, moshën si dhe karakteristika të tjera demografike dhe ndikimin e tyre në procesin e komunikimit. Pas përfundimit të lëndës studentët do të fitojnë aftësi të komunikuarit të nevojshme për punën në grupe përmes pjesëmarrjes së tyre në hulumtime dhe gjithashtu do të fitojnë aftësi për t'i prezantuar këto projekte kërkimore.

- **Arsyetimi dhe Mendimi Kritik**

Pas përfundimit të suksesshëm të lëndës, studentët, do të jenë në gjendje që ta përmirësojnë mënyrën e tyre të menduarit, përmes të kuptuarit të strukturave të brendshme të procesit të menduarit dhe duke i rishikuar ato në kuadër të standardeve individuale dhe akademike. Ata, do të zhvillojnë strategji të vendimmarrjes, të bazuara në reflektim, arsye dhe logjikë. Përmes kësaj lënde, studentët, do të mësojnë se në bazë të cilave tendenca, ngjashmëri dhe supozime bazohen reflektimet e tyre, si dhe cilat kushte dhe pasoja lindin nga mënyra e tyre e menduarit. Ky mendim reflektues, nënkupton një rishikim aktiv, të kujdesshëm dhe të vazhdueshëm të të gjitha besimeve individuale në lidhje me fundamentin që i mbështesin ato dhe konkluzionet që dalin prej tyre. Studentët pritet të fitojnë njohuri dhe aftësi për të marrë vendime të kapshme, të nevojshme në mjedisin e përditshëm në lidhje me profesionet e tyre të ardhshme.

- **Marrëdhëniet me Publikun dhe Mediat e Reja**

Lënda, do të fokusohet në zhvillimin e aftësive komunikuese dhe të teknikave që janë të domosdoshme për funksionimin efektiv në epokën e globalizimit. Studentët, do ta përpunojnë procesin e globalizimit, aspektet sociale, aspektet politike, ekonomike dhe kulturore të fenomenit modern, si dhe pasojat dhe ndikimet në sferën e komunikimit, të cilat njëherësh karakterizuan edhe një epokë të postmodernizmit, veçanërisht ndikimin e mediave të reja sociale, strukturën dhe funksionin e tyre, multilingualizmin në rrjetet sociale, efektet dhe pasojat në realitetet moderne të komunikimit në botë.

- **Media dhe Shoqëria**

Mediat dhe Shoqëria paraqet hyrje të studentëve në një disiplinë, e cila i studion marrëdhëniet komplekse mes mediave dhe shoqërisë, rolin e mas mediave si teknologji ndërmjetësuese gjatë komunikimit masiv dhe global. Qëllimi i veçantë i lëndës janë implikimet politike, sociale dhe kulturore të mediave mbi shoqërinë.

- **Hyrje në Ekonomi dhe Biznes**

Qëllimi kryesor i kësaj lënde është ta zhvillojë kuptimin bazik të koncepteve dhe teorive kryesore ekonomike, të cilat përdoren për analizë të çështjeve ekonomike. Kjo lëndë është e dizajnuar në atë formë që t'u mundësojë studentëve të pajisen me njohuri për parimet bazë, me konceptet dhe teknikat në fushën e ekonomisë si shkencë, si dhe në analizat ekonomike. Kjo lëndë siguron hulumtimin e parimeve të mikroekonomisë dhe makroekonomisë, duke u fokusuar në implementimin e dijes në sjelljen e vendimeve në një ambient global. Pas mbarimit të lëndës, studentët duhet të aftësohen: ta përdorin modelin e ofertës dhe kërkesës dhe ta përcaktojnë ndikimin e ndryshimeve të kërkesës dhe ofertës mbi çmimin dhe sasinë; ta definojnë PBB (GDP) dhe të kalkulojnë matjen, përdorimin dhe kufizimin e PBB (GDP), si një mjet i mirëqenies ekonomike; ta definojnë inflacionin dhe ta kalkulojnë atë, të njihen me pasojat dhe si të përshtaten në to; si dhe t'i përshkruajnë rolet dhe mjetet e bankës qendrore.

- **Principles of Management**

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët që njoftohen me bazat e menaxhmentit, gjenezën dhe përkufizimin e tij, si dhe me parimet themelore në të cilat do të bazohet puna e secilit menaxher të ardhshëm. Ndjekja e kësaj lënde ka për qëllim që studentët të përfitojnë njohuri themelore nga fusha e funksioneve bazike në menaxhment si planifikimi, organizimi, koordinimi, motivi dhe kontrolli. Të mësuarit e kësaj lënde studentëve do t'u mundësojë: T'i mësojnë bazat e menaxhmentit dhe të aftësohen për to që të japin shembuj konkretë. Të aftësohen ta shohin këtë lëndë si nevojë për fitimin e njohurive, të cilat do të jenë në kontekst të zbatimit në praktikë të asaj që kanë mësuar. Të mendojnë në mënyrë efikase që do t'u ndihmojë të përballen me problemet afariste në jetën e tyre të mëtuajtshme.

- **Menaxhimi i Projekteve**

Qëllimi i lëndës është që të inkuadrohen studentët në botën e projekteve moderne dhe t'i ballafaqojë ata me mundësitë dhe me sfidat e jetës reale ekonomike në krijimin e projekteve të përshtatshme për nevojat reale. Qëllimet specifike të lëndës janë: si të përcaktohet një projekt i caktuar (duke përdorur disa faza) dhe të theksohet roli i rëndësishëm i menaxherit të projektit (të kuptohen nevoja, fusha e veprimit, aktivitetet për implementim, kompleksiteti i dizajnit modern, etj.). Studentët duhet të trajnohen se si të aplikojnë mjete dhe teknika moderne të menaxhmentit modern të projektimit me rastin e transformimit të nevojës, ose të ideojnë krijuese në një projekt real e të dokumentuar, i cili do të bëjë të jenë më inventivë për vete dhe më kompetitivë në tregun më konkurrues të punës.

- **Plani i Biznesit**

Qëllimi i lëndës është që t'u ndihmojë studentëve për të kuptuar sjelljen e vetëdijshme të ndërmarrjes në kushtet bashkëkohore të afarizmit.

- **Etika dhe përgjegjësia shoqërore e korporatave**

Qëllimi i lëndës është që të zhvillojë njohuri të përgjithshme teorike të përgjegjësisë korporative sociale në ekonominë moderne dhe të analizojë reflektimin e përgjegjësisë korporative sociale në funksionimin e përgjithshëm të ndërmarrjes.

- **Gjuhë Frënge 1-2-3**

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët t'i forcojnë bazat dhe aftësitë gjuhësore, si dhe t'i zhvillojnë katër kompetencat e komunikimit, veçanërisht në fushat e mëposhtme: të jenë në gjendje të shprehin një mendim, të jenë në gjendje t'i shprehin ndjenjat, ta kuptojnë thelbin e një shprehje, mendimi apo ideje, të jenë të aftë të argumentojnë dhe mbrojnë mendimin e tyre. të gjinden në situata të ndryshme, të mbajë një fjalim të thjeshtë dhe koherent, të rrëfejnë një ngjarje, të rrëfejnë një ëndërr ose përvojë, të paraqesin arsyet për një projekt ose ide, të komunikojnë në mënyrë spontane.

- **Gjuhë Italiane 1-2-3**

Qëllimi i mësimdhënies është që studentët të njihen me kulturën italiane, civilizimin Italian dhe gjuhën italiane. Ideja është që studentët të njohin një realitet tjetër, i cili do t'u ndihmojë në formimin e një ego të vetes, po ashtu edhe në krijimin e një fotografie për veten dhe të ardhmen e tyre. Në përputhje me nivelin (nga A1 deri B2), të cilën studentët do ta zgjedhin, ose nivelet, që do t'i ndjekin në semestrat që i kanë në dispozicion si një lëndë zgjedhore, materia thellohet në mënyrë progresive. Në nivelin e parë fillohet me të dhënat bazike, si p.sh: drejtshkrimi, shqiptimi, terminologjia për menaxhimin me situatat e ndryshme gjuhësore të përditshmërisë (prezantimi i vetes, prezantimi i të tjerëve, orientim në hapësirë dhe kohë, shprehje komunikuese në ndonjë lokal, në restorant, supermarket, në treg), ndërsa arrihet deri në konstruksione më të ndërlikuara në nivelet në vazhdim, që kanë të bëjnë me dhënien e një qëndrimi, dëshire, nevojë, sqarimi të ndodhive të shkuara, të folur të ndodhive të ardhshme, etj. Gramatika prezantohet në mënyrë induktive (nëpërmjet vetëdijesimit nga situatat (audio incizime, video filma, tekste) dhe sjellje të konkluzioneve), në të cilën rolin kryesor e kanë vetë studentët, me pjesëmarrjen e tyre aktive në ligjërata.

- **Të Shkruarit Akademik në Gjuhën Angleze**

Në këtë lëndë do të zhvillohen shkathtësitë akademike të të shkruarit të studentëve në mënyra të ndryshme. Studentët, do të aftësohen t'i komunikojnë idetë e tyre në mënyrë të qartë, të rrjedhshme dhe efektive që të prodhojnë një pjesë të shkruar. Gjithashtu, studentët do të njoftohen me rregullat e citimit dhe parafrazimit dhe do të vetëdijësohen se çka është plagjiatura. Informata kthyesë e një pjese të shkruar, do të përfshijë vetëkorrigjimin, korrigjimin e njëri-tjetrit dhe korrigjimin nga ana e mësimdhënësit të përmbajtjes, organizimit dhe gabimeve gjuhësore gjatë procesit të të shkruarit.

- **Arsimim Online dhe Digjital**

Lënda Arsimimi Online dhe Digjital, është lëndë një-semestrale me 3 orë në javë, e cila ofrohet në studimet deridiplomike. Lënda është e përpiluar në bazë të nevojave të studentëve dhe në vete ngërthen shkathtësi të ndryshme të shekullit 21, të cilat janë të lidhura me përdorimin efektiv të teknologjisë. Lënda përmban tri kategori të shkathtësive të shek 21. Pas mbarimit të lëndës, studentët do të jenë në gjendje të kërkojnë dhe të kenë qasje në informatat online, duke përdorur vegla të ndryshme digjitale, të vlerësojnë në mënyrë kritike vërtetësinë e materialeve online dhe të bëjnë dallim mes burimeve të vërteta dhe të rrejshme, të tregojnë mirëkuptim për problemet etike në kontekstin akademik, të kuptojnë si përdoren citatat në mënyrë të drejtë, të mësojnë si kryhet komunikimi profesional në mënyrë efektive, t'i kuptojnë gjërat bazike të sigurisë në internet, si dhe aspektet pozitive dhe negative të krijimit të identitetit online, ta hetojnë shqetësimin-sajber dhe t'i identifikojnë zgjedhjet e mundëshme për zvogëlimin e online shqetësimeve.

- **Gjuhë Angleze për Bashkëbisedim**

Gjuhë Angleze për Bashkëbisedim është lëndë një-semestrale e hartuar për folësit e gjuhës angleze të nivelit të mesëm dhe më lartë. Lënda, do të jetë në dispozicion për studentët në të gjitha semestrat. Anglishtja është një gjuhë ndërkombëtare, që e lehtëson komunikimin në kontekste të ndryshme në mbarë botën, duke filluar nga takimet e biznesit dhe transaksionet në bisedat e rastësishme midis miqve dhe ndërveprimeve gjatë udhëtimit. Anglishtja, në bisedë, do të ndërtojë aftësitë e të dëgjuarit dhe të folurit e studenteve, duke ofruar gramatikë, fjalorin, shqiptimin dhe praktikën e rrjedhshmërisë së nevojshme për llojet e zakonshme të ndërveprimeve të folura angleze. Lënda do të mbulojë tema që lidhen me bisedën profesionale, bisedat e rastësishme dhe ndërveprimet e përditshme, duke u siguruar studentëve besimin e bisedave në një kontekst të ndryshëm. Biseda profesionale, do të përfshijë lloje formale dhe të sjellshme të fjalimit të përdorura në kontekste të tilla, si takime pune, ose diskutime me kolegët.

Biseda e rastësishme, do të përfshijë praktikën me gjuhën e përdorur gjatë shoqërimit me miqtë, ose familjen dhe situata të tjera joformale dhe do të përfshijë zhargon dhe fjalim joformal. Ndërveprimet e përditshme, do të përfshijnë biseda në dyqane, gjatë udhëtimit dhe duke kërkuar ndihmë. Metodatat e të mësuarit, do të fokusohen në praktikë dhe do të përfshijnë aktivitete dëgjimi, dialogë, role, simulime, debate dhe diskutime.

- **Shkathtësi Komunikuese në Kontekst profesional në anglisht**

Qëllimi i lëndës është të zhvillojë aftësitë e komunikimit që janë thelbësore për funksionimin efektiv në botën profesionale në anglisht. Objektivat e lëndës përqendrohen në një gamë të gjerë mjedisesh dhe çështjesh profesionale. Studentët, do të hulumtojnë procesin e analizës së situatave të ndryshme të komunikimit dhe në përputhje me rrethanat do t'i kuptojnë ato.

- **Beletristike dhe Argëtim**

Lënda synon të eksplorojë një sërë tekstesh tërheqëse dhe të njohura letrare (romane, fragmente, lektura dhe tregime të shkurtra), në mënyrë që të kuptohen dhe shijohen karakteristikat e zhanreve të ndryshme të njohura, duke përfshirë trillimet shkencore, letërsinë për të rinj dhe fantastikën. Ndër objektivat e lëndës, mund të përfshihen me sa vijon: të zhvilluarit e vetëbesimit të studentëve, rrjedhshmërisë dhe interesit për të lexuar në anglisht, të lexuarit e llojeve të ndryshme të romaneve dhe dhënies së përgjigjeve të logjikshme dhe të mprehta, me gojë dhe me shkrim, duke krijuar një lidhje midis përvojës personale, njohurive globale dhe/ose burimeve të tjera (leksioneve, teksteve të leximit, filmave) dhe tekstit të caktuar. Për më tepër, qëllimet janë transferimi i aftësive të përparuara të leximit në klasën e gjuhës së dytë dhe zhvillimi i këtyre aftësive, duke i bërë studentët lexues më të mirë në të dy gjuhët. Shkathtësitë e të lexuarit përfshijnë: përshkrimin, skanimin, parashikimin, të qëlluarit e fjalëve nga konteksti dhe leximin për një kuptim më të hollësishëm.

- **Letërsi Angleze dhe Filmi**

Qëllimet e lëndës janë, si vijon: të ndihmuarit e studentëve të zhvillojnë aftësitë e të menduarit kritik përmes analizës së filmit; diskutimi, vlerësimi dhe përpilimi i komenteve kritike; analiza kritike e teksteve letrare dhe informuese; diskutimi dhe analiza e punës së studentëve dhe vlerësimi nga kolegët/shokët; paraqitja e perspektivave të ndryshme, mbështetja e pretendimeve, përdorimi i gjuhës shqisore.

- **Gjuha Maqedonase për Terminologji Juridike dhe të BE**

Qëllimi i lëndës është t'i aftësojë studentët për kompetencë dhe performancë gjuhësore në fushën profesionale (d.m.th. në fushën e të drejtës dhe BE-së). Bëhet fjalë për një koncept të përqendruar te studenti (learner-centered approach), e që thekson zhvillimin e aftësive të komunikimit në fusha specifike, d.m.th. thellimin dhe përfundimin e aftësive për shprehje të përparuar me shkrim dhe me gojë në gjuhën standarde maqedonase. Materiali i synuar përfshin përmbajtje në lidhje me disiplinat profesionale, si dhe dokumente dhe materiale autentike. Vëmendje e veçantë i kushtohet zotërimit të terminologjisë profesionale dhe zbatimit të saj në kontekst të përshtatshëm gjuhësor dhe zhvillimit të aftësive digjitale. Studentët pritet të bëhen më autonomë në mësimin e gjuhës dhe të jenë në gjendje të mendojnë në mënyrë kritike për një larmi temash, si dhe të fitojnë aftësinë për të komunikuar në gjuhën maqedonase në një mjedis shumëgjuhësh dhe multikulturor.

- **Etika në institucionet publike**

Qëllimet e planprogramit të lëndës : Të ketë njohuri dhe ta kuptojë semantikën dhe konceptet e moralit e të etikës, standardet e sjelljes, arsyetimin moral dhe filozofinë morale. Të zhvillojë qëndrim për pozitën e moralit në jetën profesionale. Të formojë qëndrime të qarta për të drejtat dhe detyrimet e të punësuarve në administratën publike dhe atë shtetërore. Të ketë aftësi për t'u ballafaquar me situata problematike etike. Ta ketë ndjenjën e karakterit të nevojshëm në profesionin e administratorit. Të njihet me literaturë për etikën në sferën e institucioneve publike. Të ketë gatishmëri për të përdorur mjete të komunikimit dhe të respektojë standardet etike në punën në institucionet shtetërore dhe aktorëve publikë.

- **Historia e arkitekturës dhe artit**

Qëllimi i lëndës është njohja e studentëve me mjediset themelore teorike, si dhe me zhvillimin e arkitekturës, artit dhe dizajnit nga fillimet e tyre deri në shfaqjen e Rilindjes në skenën kulturore dhe artistike në Evropë. Programi paraqet të gjitha periudhat më të rëndësishme historike dhe stilistike, stilet unike si produkte të nivelit të zhvillimit të teknologjisë, shkencës dhe kulturës, veçanërisht të rëndësishme për zhvillimin e arkitekturës dhe artit të përgjithshëm.

- **Shprehje vizuale**

Qëllimi i lëndës është një njohje e thelluar dhe e avancuar e studentëve me metodologjitë dhe parimet e shprehjes vizuale në funksion të një prezantimi të plotë vizual të detyrave, ideve dhe koncepteve të projektit.

- **Marketingu Dixhital**

Qëllimi i lëndës së marketingut digjital është t'u ofrojë studentëve njohuri për avantazhet e biznesit duke përdorur marketingun digjital dhe rëndësinë e tij për suksesin e marketingut të një organizate. Marketingu digjital është vendi ku marketingu takohet me internetin dhe format e tjera të mediave të reja. Ai përfshin reklamimin online dhe pjesëmarrjen në media sociale, media të ndryshme digjitale dhe mënyrën e krijimit të përmbajtjeve në marketing, optimizimin e një faqe në internet dhe optimizimin e SEO-së; ofrimi i njohurive bazë rreth Google Analytics për matjen e efekteve të marketingut digjital dhe fitimi i njohurive të tendencave të ardhshme. Njohuritë, aftësitë dhe kompetencat e fituara do t'i ndihmojnë studentët të hartojnë dhe vlerësojnë një plan marketingu digjital në mënyrë që të menaxhojnë në mënyrë efikase një performancë të marketingut digjital.

- **Dizajn grafik**

Qëllimi i lëndës: Njohja me dizajnin grafik dhe metodat e aplikimit në dizajnin e enterierit, si për prezantime ashtu edhe për zbatime reale.

- **Materialet, metodat dhe produktet**

Qëllimi i lëndës: Përvetësimi i njohurive bazë për materialet ndërtimore dhe rolin që ato kanë në ndërtim, materialet e përdorura për elementet strukturore në një ndërtesë, si dhe materialet për mbrojtjen dhe izolimin e elementeve të ndryshme në një objekt. Njohja me vetitë themelore të materialeve ndërtimore, përdorimi i tyre në konstruksione ndërtimi dhe në objekte të ndryshme arkitekturore. Aplikimi i materialeve të përshtatshme të ndërtimit në procesin e projektimit, mënyra bashkëkohore e inkorporimit të tyre gjatë kryerjes së konstruksioneve, izolimit dhe formësimit të fasadës së ndërtesave.

- **Financat personale**

Lënda ofron një hyrje praktike në menaxhimin financiar personal. Duke përdorur një qasje të strukturuar, hap pas hapi, studentët ndihmohen të mësojnë se si të kursejnë dhe investojnë, të menaxhojnë kreditë studentore, të llogarisin taksat, të reduktojnë borxhin e kartës së kreditit dhe të planifikojnë për të ardhmen. Skenarët e jetës reale që mbulojnë një gamë të gjerë sfidash financiare i lejojnë studentët të vlerësojnë rëndësinë e koncepteve kryesore, si dhe këshilla të dobishme nga ekspertët e financave personale për t'i ndihmuar ata t'i zbatojnë ato koncepte në jetën e tyre. Shembuj të ndryshëm matematikorë do të ilustrojnë qartë rëndësinë kritike të arritjes së qëllimeve financiare afatgjata përmes investimit. Kursi angazhon studentët dhe përqendron vëmendjen e tyre në konceptet kritike që u nevojiten për të pasur sukses në zotërimin dhe menaxhimin me mençuri të aseteve të tyre financiare gjatë gjithë jetës.

- **Komunikimi Afarist**

Qëllimi i kësaj lënde është që t'i njoftojë studentët me konceptet e komunikimit të biznesit. Përmbajtja e programit është si në vijim: në vitet e fundit gjithnjë e më shumë kompani i përdorin teknikat e komunikimit të biznesit si një mjet kyç për t'iu përgjigjur konkurrencës gjithnjë e më të ashpër në tregun global. Kjo lëndë është një përpjekje për t'i përmirësuar aftësitë e komunikimit të studentëve me tregues teorikë dhe para së gjithash me demonstrime praktike të mënyrës së drejtë të komunikimit në një mjedis organizativ me të punësuarit dhe menaxherët, si dhe mbajtjes së takimeve, intervistimin, se si të përgjigjen gjatë intervistës, negocimi dhe motivimi i të gjithëve në rrethin tyre.